



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komsioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. 109 Datë 26/05/26



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
OFK-SE 2026

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 me nënparagrafin 1.1 , 1.6 dhe 1.11 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 26.05.2026, miraton këtë:

VENDIM

- I. Miratohen formatet standarde të procesverbaleve për procesin zgjedhor të Kuvendit të OFK-së, përkatësisht:
 - Procesverbali i mbylljes së votimit;(FPR)
 - Procesverbali i numrit të votave të kandidatëve; (FRK)
 - Procesverbali për kandidatët e zgjedhur për anëtarë të Kuvendit të OFK-së.
- II. Këto procesverbale përfshijnë evidentimin e materialit zgjedhor, përputhjen e fletëvotimeve të pranuar, të përdorura, të papërdorura dhe të dëmtuara, evidentimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme, numrin e votave për secilin kandidat, si dhe renditjen e kandidatëve të zgjedhur sipas rezultateve përfundimtare.
- III. Miratohet edhe “Doracaku i Procedurave të Votimit dhe Numërimit – Zgjedhjet për Kuvendin e Odës së Farmacistëve të Kosovës 2026”, i cili përcakton procedurat për administrimin e procesit zgjedhor nga Komisionet e Njësive Zgjedhore (KNJZ), duke përfshirë hapjen dhe mbylljen e vendvotimeve, procedurat e votimit, numërimin e votave, plotësimin e procesverbaleve, publikimin e rezultateve dhe dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQZ.
- IV. Procesverbalet dhe doracaku i miratuar sipas pikave I dhe III të këtij vendimi i bashkëngjiten këtij vendimi dhe përbëjnë pjesë përbërëse të tij.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Gjyqin e Nderit të OFK-së, deri më datë 28.05.2026, përmes adresës elektronike: kqz.ofk1@gmail.com.

I’dergohet :

- Komisionit te njesive zgjedhore
- Sekretariatit te KQZ-se

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komsioni Qendror i Zgjedhjeve
OFK - KQZ

Kryetari i KQZ-së

Mr.Ph. Betim Ramadani

Faqe 1 nga 1